



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS LIDHUR ME VIZITËN NË BURGUN E SIGURISË SË LARTË

Për: Znj. Albulena Haxhiu, ministre
Ministria e Drejtësisë

Z. Arben Vitia, ministër
Ministria e Shëndetësisë

Kopje: Ismet Krasniqi, sekretar i përgjithshëm
Kuvendi i Republikës së Kosovës

Z. Rasim Selmanaj, ushtrues detyre i drejtorit të përgjithshëm
Shërbimi Korrektues i Kosovës

Z. Milazim Gjocaj, drejtor
Departamenti Shëndetësor në Burgje

Z. Samedin Mehmeti, drejtor i përgjithshëm
Policia e Kosovës

Z. Burim Buleshkaj, drejtor
Burgu i Sigurisë së Lartë

Z. Habit Hajredini, drejtor
Zyra për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit

Prishtinë, më 14 korrik 2021

HYRJE

Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës (më tej: MKPT), bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, mund t'i vizitojë, në çdo kohë dhe pa paralajmërim, të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë stacionet policore, qendrat e paraburgimit, burgjet, vendet ku mbahen të huajt e privuar nga liria, qëndrimi i të cilëve në Republikën e Kosovës bie ndesh me ligjet në fuqi dhe të cilët janë subjekt i kthimit me forcë nga Republika e Kosovës, si dhe institucionet psikiatrike dhe ato të kujdesit social.

Bazuar në këtë mandat, MKPT-ja, më 30 mars dhe më 12 prill 2021, vizitoi Burgun e Sigurisë së Lartë (më tej: BSL). Për shkak të pandemisë COVID-19, MKPT-ja e realizoi këtë vizitë me një metodologji më të reduktuar dhe në përputhje me gjendjen me COVID-19 në vend.

Objektivi i kësaj vizite ishte vlerësimi i respektimit të të drejtave themelore të njeriut në raport me të burgosurit, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, si dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria.

Bashkëpunimi me MKPT-në gjatë vizitës

1. Gjatë vizitës së MKPT-së të realizuar në BSL, personeli i shërbimit korrektues dhe personeli i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve (më tej: DShB) i ofruan ekipit monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipi, pa vonesa, pati qasje në të gjitha vendet e vizituara. Ekipit i janë siguruar të gjitha informatat e nevojshme për ta kryer detyrën dhe i janë mundësuar bisedat me personat e dënuar dhe të paraburgosur, pa praninë e zyrtarëve korrektues dhe të personelit shëndetësor.

Njoftimi i të burgosurve për të drejtat e tyre

2. Neni 32, paragrafi 2, i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (më tej: LESP) përcakton shprehimisht: *“Me rastin e pranimit në institucionin korrektues, personi i dënuar njoftohet me shkrim për të drejtat dhe detyrimet që i ka gjatë mbajtjes së dënimit. Personi i dënuar i cili nuk dinë shkrim dhe lexim njoftohet gojarisht.”* MKPT-ja ka vërejtur se në krahët e pavijoneve janë të vendosura njoftime të ndryshme për të drejtat e të burgosurve, si dhe informata për COVID-19 dhe për masat për parandalimin e përhapjes.

Keqtrajtimi fizik

3. Gjatë vizitës në këtë qendër, MKPT-ja nuk mori ankesa për keqtrajtim fizik, për përdorim të tepruar të forcës fizike nga zyrtarët korrektues, apo për sjellje të cilat bien ndesh me respektimin e dinjitetit të të burgosurve. MKPT-ja ka vërejtur se niveli i komunikimit interaktiv ndërmjet zyrtarëve korrektues dhe të të burgosurve ishte në nivel të kënaqshëm.
4. Ekipi monitorues, gjatë vizitës i intervistoi të paraburgosurit e akomoduar në BSL për të kuptuar më shumë lidhur me trajtimin e tyre nga Policia e Kosovës dhe për respektimin e të drejtave të tyre themelore, që nga momenti i arrestimit. MKPT-ja nuk mori ankesa nga të paraburgosurit sa i përket trajtimit dhe respektimit të të drejtave të tyre themelore nga Policia e Kosovës, që nga momenti i arrestimit.

Kushtet e akomodimit

5. LESP-ja shprehimisht përcakton se i dënuari ka të drejtë për strehim, i cili u përgjigjet kushteve bashkëkohore higjienike dhe rrethanave vendore klimatike.¹ Më tej ligji përcakton: *“Lokalet në të cilat jeton dhe punon personi i dënuar, duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme, ashtu që secili person i dënuar të ketë së paku tetë (8) metra katrorë hapësirë për qeli të vetme dhe katër (4) metra katrorë për të dënuarit në qeli të përbashkëta, si dhe sasi të mjaftueshme të dritës natyrore dhe artificiale për punë, lexim, ngrohje dhe ajrosje.”*² Për më shumë, ky ligj përcakton se lokalet nuk duhet të kenë lagështi, duhet të kenë pajisje sanitare adekuate dhe mjete të tjera të nevojshme për higjienë personale.³
6. Kushtet e akomodimit në BSL në përgjithësi janë në nivel të kënaqshëm në shumicën e pavijoneve dhe hapësirave të tjera, në kuptim të hapësirës, pastërtisë, si dhe qasjes në dritë natyrore dhe artificiale. Të gjitha qelitë kanë TV, tualete të ndara dhe të burgosurit mund të bëjnë dushe sa herë që duan. Përveç kësaj, qelitë janë të pajisura me krevate, me çarçafë, me tavolinë, me karrige dhe me sistem të thirrjes.
7. Megjithatë, MKPT-ja ka vërejtur se dyshemetë në Pavijonin 2 (krahët D dhe E në korridore dhe nëpër qeli) janë dëmtuar shumë. Përmes Raportit, MKPT-ja u kishte rekomanduar autoriteteve kompetente që të ndërmarrin veprime për t'i mënjanuar këto dëmtime. **Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur se në stacionarin e BSL-së u mënjanuan këto mangësi.** Sa i përket qasjes së personave me aftësi të kufizuara, të gjithë ashensorët ishin funksionalë, gjë që e mundëson qasjen e të burgosurve me aftësi të kufizuara.

Regjimi

8. Gjatë vizitës së MKPT-së, të pranishëm ishin 154 të burgosur, 20 prej tyre janë të paraburgosur, ndërsa kapaciteti zyrtar i BSL-së është për 390 persona. Sa i përket regjimit, MKPT-ja gjatë vizitës u njoftua se rreth 70% e të burgosurve janë të angazhuar në punë të ndryshme, siç është mirëmbajtja, pastrimi i pavijoneve, puna në kuzhinë, në punëtorinë për prodhim të letrës higjienike dhe të qeseve, nga ku furnizohen edhe institucionet e tjera të ShKK-së.
9. Gjatë vizitës, MKPT-ja vërejti se të punësuarit në kuzhinë nuk kanë librezë sanitare. **MKPT-ja konsideron se autoritetet kompetente duhet t'i ndërmarrin veprimet e nevojshme dhe ta mënjanojnë këtë mangësi sa më shpejt që të jetë e mundur.**
10. Të dënuarit mund të lëvizin të lirë brenda pavijoneve ku ishin të vendosur, përveç në rastin e të paraburgosurve. Të burgosurit kanë të drejtë për 3 orë shëtitje në ditë gjatë stinës së verës, kurse gjatë dimrit deri në 2 orë në ditë.⁴ Po ashtu, 10 të burgosur përfunduan trajnimin për menaxhim të zemërimit. Në dispozicion të të burgosurve është edhe salla e fitnesit, të cilën të burgosurit nga Pavijoni 2 mund ta shfrytëzojnë çdo ditë, ndërsa të tjerët dy herë brenda javës.

¹ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 36, paragrafi 1.

² Ligji nr. 05/L-129 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 3, paragrafi 2.

³ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 36, paragrafi 3.

⁴ Sipas nenit 37 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, të dënuarit kanë të drejtë për së paku dy orë shëtitje.

11. Përmes raporteve të mëparshme, MKPT-ja ka ngritur shqetësimin sa i përket gjendjes në terrenet sportive në BSL, të cilat për shkak të ngjyrosjes me ngjyrë të bardhë, shkaktonin reflektim të fuqishëm dhe i pengonin të burgosurit për zhvillimin e aktiviteteve jashtë qelisë. MKPT-ja përmes raportit me rekomandime të publikuar më 25 nëntor 2019 u kishte rekomanduar autoriteteve kompetente që të mënjanoheshin këto mangësi. **Megjithatë, MKPT-ja gjatë vizitës së fundit vërejti se këto mangësi nuk janë mënjanuar dhe se përdorimi i këtyre fushave sportive nga të burgosurit ende paraqet problem për shkak të reflektimit.**
12. Gjatë vizitës, MKPT-ja pranoi ankesa nga të paraburgosurit për shkak të mungesës së aktiviteteve dhe mbylljes nëpër dhoma. Në rastin e të paraburgosurve, angazhimi i tyre në punë varet nga leja e gjykatës. MKPT-ja vëren se sa i përket angazhimit në punë të të paraburgosurit, neni 199, paragrafi 2, i Kodit të Procedurës Penale përcakton si në vijim: *“I paraburgosuri mund të kryejë punë të nevojshme për mbajtjen e rendit dhe pastërtisë në ambientin e tyre. Të paraburgosurit mund t’i lejohet të punojë në aktivitete që i përgjigjen aftësive fizike dhe mendore brenda mundësive dhe kushteve me të cilat disponon institucioni dhe me kusht që të mos e dëmtojë procedurën penale. Gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vendos për këtë në marrëveshje me drejtorinë e institucionit.”*
13. Ndërsa neni 200, paragrafi 1, i LESP-së, lidhur me angazhimin e të paraburgosurit në punë përcakton si në vijim: *“I paraburgosuri mund të angazhohet me punë në punëtori, punëtoritë e njësisë ekonomike të cilat gjenden në rrethin e institucionit korrektues përkatës, pas marrjes së pëlqimit të gjykatës kompetente.”*
14. MKPT-ja edhe përmes këtij raporti konsideron se bazuar në legjislacionin në fuqi, si dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, autoritetet kompetente të Republikës së Kosovës duhet të bëjnë përpjekje që të rritin angazhimet jashtë qelisë për të paraburgosurit, për aq sa një gjë e tillë është e mundur.

Kujdesi shëndetësor, personeli dhe infrastruktura

15. Neni 4 i Ligjit nr. 05/L-129 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton të drejtën e personit të dënuar që t’i gëzojë të njëjtat standarde të kujdesit shëndetësor, të cilat janë në dispozicion në komunitet. Personi i dënuar ka qasje në shërbimet e nevojshme shëndetësore pa pagesë.
16. Personeli i njësisë shëndetësore në BSL përbëhet prej tre mjekëve të përgjithshëm të rregullt, gjashtë infermierëve, ku katër prej tyre punojnë me ndërrim 12 orësh dhe në thirrje, ndërsa të tjerët punojnë me orar prej orës 8 deri në orën 16, një psikolog me orar 8-16, çdo ditë, ndërsa stomatologia është e angazhuar me orar të rregullt (8-16) çdo ditë.
17. Po ashtu, nga jashtë kardiologu i përgjithshëm ofron shërbime të specializuara, njësoj edhe dy psikiatër dhe një laborant jo i rregullt. Sa u përket trajnimeve për personelin shëndetësorë, nuk pati të tilla që nga fillimi i pandemisë COVID-19.
18. Furnizimi me pajisje mbrojtëse anti-COVID-19 në përgjithësi është në rregull, përveç në fazën e parë të pandemisë, ku u përballën me mungesa të përkohshme. Trajtimi psikiatrik bëhet përmes shërbimeve të specializuara (dy psikiatër në dispozicion) dhe në institucionet e tjera publike shëndetësore jashtë BSL-së. Nga dokumentacioni i analizuar dhe nga intervistat me personelin shëndetësor del se janë duke u trajtuar 34 të burgosur

me sindroma neurotike. **Hapësirat në të cilat ofrohet kujdesi shëndetësor** në përgjithësi janë adekuate dhe të një standardi të lartë, si dhe të pajisura mirë me të gjitha pajisjet e nevojshme.

19. Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur se i burgosuri D. O., me gjendje të rënduar të shëndetit mendor, u transferua nga Qendra e Paraburgimit në Gjilan për në BSL, ku edhe i shkaktoi vetes lëndime serioze trupore pasi ia vuri flakën qelisë ku ishte i akomoduar. Falë reagimit të shpejtë të zyrtarëve korrektues dhe shërbimeve të tjera, u mënjanua më e keqja. MKPT-ja ka vërejtur se për shkak të gjendjes së tij shëndetësore u rekomandua dërgimi i tij në Institutin e Psikiatrisë Forenzike, por për shkak të mungesës së kapacitetit, instituti në fjalë fillimisht pati vështirësi për ta akomoduar të burgosurin.
20. Edhe përmes kësaj vizite, MKPT-ja vëren se vazhdon të jetë sfidë prania e kohëpaskohshme e të burgosurve me sëmundje mendore, për shkak të mungesës së kapaciteteve për t'i akomoduar në institucione përkatëse të burgosurit e kësaj kategorie.
21. Në këtë drejtim, standardet e KPT-së përcaktojnë si në vijim: *“Një i burgosur i sëmurë mendor duhet të mbahet dhe përkujdeset në një mjedis spitalor që është i pajisur përshtatshëm dhe që ka personelin e trajnuar siç duhet. Ai mjedis mund të jetë një spital psikiatrik civil ose një mjedis psikiatrik i pajisur posaçërisht brenda sistemit të burgut.”*⁵
22. Rregullat Evropiane të Burgjeve, Rregulli 12.1, përcaktojnë si në vijim: *“Personat të cilët vuajnë nga sëmundjet mendore të cilat nuk janë kompatible me akomodimin në burg duhet të akomodohen në institucionin e paraparë veçanërisht për këtë qëllim.”*⁶
23. Rregullat e Mandelës, Rregulli 109, përcaktojnë se të burgosurit me probleme mendore nuk duhet të mbahen në burgje, por duhet të bëhen përpjekje që ata të transferohen në institucione përkatëse sa më shpjet që të jetë e mundur.
24. MKPT-ja inkurajon autoritetet kompetente që të bëjnë përpjekje të vazhdueshme që këta persona të trajtohen në institucione përkatëse, qoftë në ndonjë njësi të veçantë psikiatrike brenda burgut, në ndonjë spital, apo në institucion psikiatrik civil.
25. **Sa i përket transportit të pacientëve jashtë BSL-së**, kjo bëhet me autoambulancë të shërbimit shëndetësor, e çila është e pajisur me të gjitha pajisjet e nevojshme dhe me personel të nevojshëm. Ndërsa rastet më të lehta për të cilat janë të nevojshme vetëm konsultimet, dërgohen në institucionet e tjera shëndetësore me automjete të ShKK-së.
26. MKPT-ja nuk mori ankesa të besueshme sa u përket shërbimeve të ofruara mjekësore. Përkundrazi, shumica e të burgosurve u shprehën në favor të trajtimit shumë të mirë mjekësor dhe respektimit të dinjitetit të të burgosurve.
27. **Parandalimi i vetëlëndimeve dhe i vetëvrasjeve** - bëhet përmes kontrolleve fillestare me rastin e pranimin të të burgosurit në institucion korrektues, ekzaminimit të shkallëzuar psikologjik, si dhe përmes angazhimit në punë dhe në aktivitete psiko-sociale. Sipas të dhënave të shërbimit shëndetësor në BSL, në vitin 2020 u evidentuan nëntë vetëlëndime, nëntë lëndime trupore, katër tentim-vetëvrasje, tetëmbëdhjetë raste të shqiptimit të masës disiplinore të vetmisë, katër raste të grevës së urisë. Ndërsa në vitin 2021, respektivisht në

⁵ Standardet e KPT-së, pjesë nga Raporti i 3-të i Përgjithshëm, paragrafi 43, publikuar në vitin 1993. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806ce943>.

⁶ Rregullat Evropiane të Burgjeve, Rregulli 47.1. Shih në: <https://rm.coe.int/european-prison-rules-978-92-871-5982-3/16806ab9ae>.

periudhën janar-shkurt, në BSL ndodhi një vetëlëndim, tri lëndime trupore, tri tentim-vrasje, një rast i grevës së urisë, gjashtë raste të shqiptimit të masës disiplinore të vetmisë dhe izolimit.

28. **Sa i përket abuzimit me droga, alkool dhe duhan**, bëhet kontrollimi sistematik i përdoruesve dhe abuzuesve të drogës, të alkoolit dhe të duhanit. Rastet identifikohen në fazën e pranimit, duke vazhduar pastaj përmes monitorimit të mëtejshëm dhe informimit të tyre lidhur me pasojat e përdorimit; bëhet trajtimi me terapi adekuate nga personeli i trajnuar për këtë kategori. Po ashtu bashkëpunojnë edhe me institucionet e tjera të cilat merren me trajtimin e kësaj kategorie.
29. MKPT-ja ka vërejtur se në dispozicion të të burgosurve është programi me metadon, i cili realizohet sipas protokollit të përcaktuar në Procedurën Standarde të Veprimit (më tej: PSV), si dhe trajtimeve dhe mbështetjes e cila ofrohet nga OJQ "Labirint" për drogat dhe trajtimin e përdoruesve në pajtim me protokollin nacional për të burgosur të sapopranuar, të cilët identifikohen si të tillë, si dhe për trajtim të atyre të cilët dalin nga burgu dhe vazhdojnë me program të metadonit. Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, asnjë i burgosur nuk ishte në programin e metadonit.

Rëndësia e kontrolleve mjekësore të të burgosurve të sapopranuar

30. KPT-ja dhe aktet e tjera juridike ndërkombëtare vazhdimisht theksojnë rëndësinë e kontrollimit mjekësor të të burgosurve të sapopranuar, veçanërisht në institucionet që përbëjnë pikë hyrjeje në sistemin e burgjeve. Një kontrollim i tillë është esencial, veçanërisht për t'i parandaluar vetëvrasjet dhe përhapjen e sëmundjeve transmetuese (siç janë tuberkulozi, hepatiti B/C, HIV).
31. Sipas KPT-së, shërbimet mjekësore të burgut mund të japin kontribut domethënës në parandalimin e keqtrajtimin fizik gjatë periudhës menjëherë para burgosjes, domethënë, në periudhën kur personat janë në mbajtje nga agjencitë e zbatimit të ligjit, përmes regjistrimit sistematik dhe me kohë të lëndimeve dhe, kur kjo është e përshtatshme, përmes sigurimit të informatave për autoritetet relevante.⁷
32. LESP-ja⁸ dhe Praktika Standarde e Veprimeve⁹ e DShB-së përcaktojnë obligimin që i burgosuri i sapopranuar t'i nënshtrohet kontrollimit mjekësor brenda 24 orëve nga momenti i pranimit.
33. Obligime të tilla përcaktohen edhe me aktet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve, siç janë: Rregullat e Mandelës¹⁰, Rregullat Evropiane të Burgjeve¹¹ dhe Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria.¹²

⁷ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti i 26-të i Përgjithshëm, paragrafi 72, në: <https://rm.coe.int/168070d0c8>.

⁸ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 31.

⁹ Praktika Standarde e Veprimit, pika 1. Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-n%C3%AB-DShB.pdf>.

¹⁰ Rregullat e Mandelës, Rregulli 34. Shih në: https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E_ebook.pdf.

¹¹ Këshilli i Evropës, Rekomandimi (2006) 2 i Këshillit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve, pika 42.1. Shih në: <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016804c221d>.

¹² Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria, pika 27, në: https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/res45_113.pdf.

34. Bazuar në pohimet e të burgosurve dhe në dokumentacionin relevant mjekësor, të burgosurit e sapopranuar kontrollohen brenda afatit prej 24 orësh nga momenti i arritjes në BSL.

Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore

35. Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore parashihet me Praktikën Standarde të Veprimit¹³, e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë; me LESP-në¹⁴; me standardet e KPT-së;¹⁵ si dhe me aktet ndërkombëtare, siç janë: Rregullat e Mandelës¹⁶ dhe Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria.¹⁷
36. Për më shumë, edhe standardet e KPT-së po ashtu përcaktojnë se të gjitha ekzaminimet mjekësore të të burgosurve duhet të kryhen ashtu që të mos shihen dhe të mos dëgjohen nga zyrtarët korrektues, përveç në rastet kur mjeku e kërkon një gjë të tillë.
37. Po ashtu, neni 25, paragrafi 3, i Udhëzimit Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, shprehimisht përcakton: “*Mjeku bënë vizitën mjekësore në kushte të konfidencialitetit mjekësor dhe normave etike profesionale.*”
38. Bazuar në intervistat me personelin shëndetësor dhe në intervistat me të burgosurit, shërbimet shëndetësore jepen pa praninë e zyrtarëve korrektues, duke ruajtur në këtë mënyrë konfidencialitetin e shërbimeve mjekësore. Po ashtu, barnat u shpërndahen të burgosurve nga personeli shëndetësor.

Kontakti me botën e jashtme

39. Legjislacioni në fuqi¹⁸, në rastin e personave të dënuar, përcakton se të burgosurit e dënuar kanë të drejtë të pakufizuar për korrespondencë (që u nënshtrohen përjashtimeve të caktuara), kanë të drejtë për një vizitë në muaj, e cila zgjat më së paku një orë, si dhe për vizitë nga fëmijët dhe bashkëshortet e tyre, së paku një herë në tre muaj, me kohëzgjatje minimale prej tri orësh.
40. Përveç kësaj, ata kanë të drejtë për të bërë thirrje telefonike. Bazuar në intervistat me të dënuarit, atyre u mundësohen vizitat familjare, vikendet, si dhe kontaktet me familjet e tyre me SKYPE. MKPT-ja ka vërejtur se komunikimi me SKYPE është mirëpritur edhe nga të burgosurit në BSL, sidomos nga të burgosurit shtetas të huaj. Prandaj MKPT-ja inkurajon BSL-në që të vazhdohet me këtë lloj komunikimi.
41. Për shkak të paraqitjes së pandemisë COVID-19, ka pasur kufizime të të drejtave në këtë drejtim, të cilat në përgjithësi nuk ishin të natyrës së prerë dhe represive dhe të cilat ishin në përputhje me gjendjen në vend, të bazuara në ligj dhe të domosdoshme për një shoqëri demokratike.

¹³ Praktika Standarde e Veprimit, pika 11. Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-n%C3%AB-DShB.pdf>.

¹⁴ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 49.

¹⁵ Standardet e KPT-së, publikuar në vitin 2018, paragrafët 50 dhe 51. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806ce943>.

¹⁶ Rregullat e Mandelës, Rregulli 26, pika 2, në: https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E_ebook.pdf.

¹⁷ Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria, pika A, Rregulli 19, në: https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/res45_113.pdf.

¹⁸ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nenet 62-65.

42. Lidhur me thirrjet telefonike, Udhëzimi Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese¹⁹ përcakton se i dënuari ka të drejtë për biseda telefonike me anëtarët e familjes së ngushtë dhe me personat e tjerë. Sipas këtij udhëzimi, biseda telefonike e personit të dënuar dhe të paraburgosur nuk mund të jetë më e gjatë se 15 minuta.
43. Të dënuarit gëzojnë të drejtën për telefonata varësisht nga regjimi, ndërsa në pavijone të caktuara telefonatat janë të pakufizuara. Në rastin e të paraburgosurve, neni 200 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës përcakton se të paraburgosurit mund të pranojnë vizita “*brenda kufijve të rregullave të qendrës së paraburgimit*” bazuar në lejen e gjyqtarit të procedurës paraprake dhe nën mbikëqyrjen e tij.
44. Më tej kodi përcakton se korrespondenca dhe vizitat e tjera i nënshtrohen vendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake. Bazuar në intervistat me të paraburgosurit, del se atyre u mundësohen dy vizita në muaj sipas lejes së gjykatës dhe një vizitë shtesë nga drejtoria, bazuar në kërkesën e parashtruar nga i paraburgosuri në rrethana të caktuara.
45. Avokati i Popullit ose përfaqësuesit e tij mund t’i vizitojnë të paraburgosurit dhe të korrespondojnë me ta pa paralajmërim paraprak dhe pa mbikëqyrjen e gjyqtarit të procedurës paraprake, të gjyqtarit të vetëm gjykues apo të kryetarit të trupit gjykues ose të personave të tjerë të emëruar nga gjyqtari i tillë. Letrat e të paraburgosurit dërguar Institucionit të Avokatit të Popullit nuk mund të kontrollohen. Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij mund të komunikojnë gojarisht ose me shkrim në mënyrë konfidenciale me të paraburgosurit. Po ashtu, të dënuarit mund t’i drejtohen MKPT-së së Avokatit të Popullit edhe përmes telefonit.
46. Në rastin e shtetasve të huaj, atyre u ofrohet mundësia që, me shkrim ose me gojë, të kontaktojnë me përfaqësinë diplomatike, apo me zyrën përkatëse të shtetit shtetësinë e të cilit e ka ai/ajo.²⁰ Gjatë vizitës, MKPT-ja ka intervistuar disa shtetas të huaj, të cilët nuk patën asnjë ankesë sa i përket trajtimit në QKD, përkundrazi, ata u shprehën në favor të marrëdhënieve mjaft pozitive, si me zyrtarët korrektues, ashtu edhe me të burgosurit e tjerë.

Çështje të ndërlidhura me sigurinë

47. MKPT-ja gjatë vizitës ka vërejtur se të gjitha hapësirat ku një gjë e tillë lejohet janë të mbuluara me kamera të sigurisë, të cilat sipas KPT-së përbëjnë garanci shtesë kundër keqtrajtimit fizik të të burgosurve, por edhe garanci për zyrtarët korrektues kundër akuzave të rrejshme për keqtrajtim fizik apo për përdorim të tepruar të forcës fizike.²¹

Incidentet ndërmjet të burgosurve

48. Bazuar në dokumentacionin relevant, MKPT-ja ka vërejtur se gjatë këtij viti, respektivisht në periudhën janar-shkurt 2021, janë regjistruar tri incidente ndërmjet të burgosurve.
49. MKPT-ja ka vërejtur se këto incidente janë mënjanuar në formularë përkatës, sipas nevojës është ofruar ndihma mjekësore dhe janë ndërmarrë veprimet e parapara me LESP.

¹⁹ Udhëzimi Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, neni 54.

²⁰ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 33, paragrafi 1.

²¹ KPT-ja, raporti për vizitën në Irlandë në vitin 2010, paragrafi 18.

Procedurat e ankesave

50. Sistemi efektiv i parashtrimit të ankesave është garancia themelore kundër keqtrajtimit në burgje dhe në qendra të paraburgimit. Personat e vendosur në këto qendra duhet të kenë mundësi për të parashtruar ankesë brenda burgut apo për t'i parashtruar ankesë qendrës së paraburgimit ku është vendosur dhe në mënyrë konfidenciale t'u mundësohet qasja tek autoriteti i duhur.
51. Neni 91 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton në hollësi procedurën sipas së cilës të paraburgosurit dhe të dënuarit mund t'i drejtohen me ankesë apo me lutje drejtorit të një institucioni të caktuar të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Procedura përfshin edhe afatet për përgjigje nga drejtori dhe mundësinë që ankesa t'i drejtohet një autoriteti tjetër, që në rastin e tanishëm është drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Korrektues dhe Ministria e Drejtësisë.²²
52. MKPT-ja ka vërejtur se në dispozicion të të burgosurve në BSL janë kutitë e ankesave, të vendosura nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, nga DShB-ja dhe nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit mund të hapen vetëm nga personeli i këtij institucioni, gjë që për ankuesit ofron konfidencialitet në parashtrimin e ankesës. Gjatë vizitës, MKPT-ja nuk mori ankesa nga të burgosurit sa i përket së drejtës për të parashtruar kërkesa dhe ankesa.
53. Në bazë të të gjeturave dhe të konstatimeve të MKPT-së gjatë vizitës, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17, paragrafi 7, të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Ministrisë së Drejtësisë:

- MKPT-ja ripërsërit rekomandimin që të ndërmerren veprimet për ta mënjanuar dëmtimin e dysHEMEVE në korridor dhe në disa qeli në Pavijonin 2.
- MKPT ripërsërit rekomandimin që të evitohet mangësia sa i përket ngjyrës së bardhë reflektuese në terrenet sportive, e cila është pengesë për aktivitete jashtë qelive.
- Të ndërmerren veprime për ta zhvilluar dhe për ta zbatuar një regjim gjithëpërfshirës të aktiviteteve jashtë qelisë për të gjithë të burgosurit.
- Të punësuarit në kuzhinë të pajisen me libreza sanitare.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar

²² Neni 91, paragrafi 4 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton: “Në ankimin e paraqitur drejtori i institucionit korrektues do të përgjigjet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, ndërsa Zyra Qendrore e Shërbimit Korrektues në afat prej tridhjetë (30) ditësh. Në ankimin me shkrim do të jepet përgjigja në formën me shkrim.”

rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.



Me nderime,

Naim Qelaj

Avokat i Popullit